

PRS.0197

SYNTECH STOPAQ

Ngjitës plastik për hidroizolim
e tubave nëpër të cilët kalojnë
kablllo

Kodi doganor

3214 9000

Amballazhimi

- Fishek 533 cc

Aplikimi

- Aplikim manual
- Pistoletë me dozë të përcaktuar
- Shpatull

Familja
Proseal

Tipologjia
Pastë mbyllëse plastike për tuba hidroizolues me kablllo kaluese

Linjat e produkteve
• Aqua
• Building
• Infratech

Kategoritë e përdorimit
• Ndalim i menjëhershëm i depërtimit të ujit me presion në ndërtesa
• Hidroizolim i ambjenteve nëntokësore me produkte hidroekspansive

Përbërësit
Monokomponent

Paraqitja
Pastë

Përshkrimi i produktit

Përbërje bllokuese me një përbërës, përgjithësisht plastik, pak i ngrohtë (+ 10% në vëllim në kontakt me ujin), përdoret për hidroizolim të vrimave nëntokësore, përmes të cilave kalojnë një ose shumë tela dhe/ose tubacione teknike në strukturat e muraturave. Aplikohet rreth kablllove që kalojnë, duke përdorur pistoletë specifike dozimi për çanta prej 600 ml dhe pastaj mbulohet me llaç tiksotropik REPAR TIX G2.

Të dhëna shtesë

- Nuk ngurtësohet me kalimin e kohës, pra ruan plasticitetin fillestar.
- Është material jotoksik.
- Është e lehtë për tu aplikuar, ngjitet si në sipërfaqet e thata dhe në ato të lagura. E përdorshme edhe në vende ku ka prani të vogël të rrjedhjes së ujit.
- Zgjerohet paksa kur bie në kontakt me ujin (+ 10%), duke mbyllur çdo hapësirë që mund të shkaktohet nga rrëshqitjet ose dridhjet.

Konsumi

Përafërsisht 1.7 fishekë SYNTECH STOPAQ për çdo decimetër kub të volumit që duhet të plotësohet.

Fushat e përdorimit

Mbyllje hidroizoluese për vrimat e shpuara në mure betoni, tulle, mure porozë etj., nëpër të cilat kalojnë kabllot elektrike dhe/ose tubat teknike të çfarëdoshëm (gazi, hidraulikë etj.).

Vetitë kryesore



I pandezshëm



Jetëgjatësia:
24 muaj



Pesha specifike:
1.20 kg/dm³



Pot life:
90 min



Produkt hidroekspansiv:
+10 %



Të përdoret me doreza mbrojtëse



Temperatura e aplikimit:
0 / +50 °C



Trashësia minimale e lejueshme:
8 cm



Ngjyrat në dispozicion
Jeshile

Veçoritë teknike

Flash-point: >190 °C

Temperatura e vetë-ndezjes: >200 °C

IF YOU WANT TO SOLVE IT
azichem

www.azichem.com

Përditësimi më: 24/08/2021
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer

Mjetet e pastrimit

- Ujë

Shtresat e lejuara

- Beton
- Parafabrikuara
- Tulla
- Shtuf
- Muratura të përziera
- Muratura me gurë
- Faqe shkëmbore

Përgatitja e shtresave (mbështetëse)

Pluhuri, dheu, rëra, pjesët e lirshme, ndryshku, shtresat e bojës së tubave dhe materialet e vjetra të prishura duhet të hiqen me ujë me presion ose me furçë përpara se të aplikohet përbërja. Sipërfaqja e brendshme e tubit / vrimës që përmban kabllo të duhet të jetë e njomë ose e lagur.

Mënyra e përdorimit

Për të kufizuar trashësinë e SYNTECH STOPAQ, është e këshillueshme që të futni një pengesë frenuese me polietilen të zgjeruar me diametër të përshtatshëm (FILTENE FONDOGIUNTO). SYNTECH STOPAQ duhet të hidhet në vrimë në mënyrë që të bllokohet, duke u kujdesur që pasta të përfshijë të gjitha kabllo. Me ndihmën e një doreze druri ose me ndonjë mjet ngjashëm ngjisheni pastën kundrejt "pengesës" së polietilenit të aplikuar më parë për të mbyllur të gjitha boshllëqet. Thellësia e bllokimit të bërë me SYNTECH STOPAQ duhet të jetë të paktën 8-10 cm.

Lëmojeni sipërfaqen e jashtme të SYNTECH STOPAQ me shpatull të posaçme ose me dorë të veshur me dorezë, duke e ngjeshur mirë. Së fundi, mbylleni "gojën" e tubit / vrimës me REPAR TIX G2, me trashësi minimale 2 cm, duke sheshuar rreth kabllove me një shpatull.

Magaznimi e Ruajtja

Ruajeni produktin në ambalazhimin original, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarit dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Mbrojeni nga lagështia.



Sekuenca fotografike




www.azichem.com

Përditësimi më: **24/08/2021**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer



Stratigrafia e përdorimit

- 1: Shtresë "kontrasti" në sfungjer, shkumë polietileni ose të ngjashme
- 2: SYNTECH STOPAQ (8-10 cm)
- 3: Sipërfaqja e vrimës me llaç tiksotropike REPAR TIX G2 (> 2 cm)



Paralajmërimi, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: www.azichem.com. Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: www.azichem.com.

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose amballazhit të tij në mjedis.

Në raste të temperaturës së ulët (përgjithësisht në dimër), fishekët SYNTECH STOPAQ duhet të nxehen në ujë në temperaturë + 35 ° C për rreth një çerek ore përpara se të përdoren (ngrohje me "banjo mari").

Për aplikime në gypa të çelikut, siguroje një shtresë të përshtatshme të primerit SYNTECH RGS epoxy në sipërfaqet që do të mbushen me REPAR TIX G2.

SYNTECH STOPAQ prodhohet/shpërndahet nga



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398



www.azichem.com

Përditësimi më: **24/08/2021**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer